

OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQËNDRUARA

PROCESVERBAL- TIPI I KONTRATËS - MALLRA

PËR ARGUMENTIMIN PËR MOS NDARJEN NË LOTE TË PROCEDURËS SË PROKURIMIT

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“BLERJE ÇADRA STREHIMI REZERVË SHTETI PËR NEVOJAT E DPRMSH-së”

VLERA E FONDIT LIMIT:

Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: 52,745,214 (pesëdhjetë e dy milion e shtatëqind e dyzet e pesë mijë e dyqind e katërbëdhjetë) lekë pa TVSH ose 537,175 (pesëqind e tridhjetë e shtatë mijë e njëqind e shtatëdhjetë e pesë) euro pa TVSH. Kursi kembimit sipas Bankës së Shqiperisë i datës 04.06.2025 është 98.19(nëntëdhjetë e tetë pikë nëntëmbëdhjetë)

Referuar Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 2 ku prashikohet shprehimisht se: “Qëllimi i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

Në kreun V, Neni 42, pikat 1 dhe 2 e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:
1. Autoriteti/enti kontraktor e ndan një kontratë në lote sa herë kjo është e mundur. Në çdo rast, duhet të përcaktohet qartë madhësia dhe objekti i këtyre loteve.

2. Autoriteti kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rast se vendos të zhvillojë procedurën e prokurimit pa e ndarë në lote, duhet të parashikojë një përcaktim të arsyeve kryesore për këtë vendim, i cili bëhet pjesë e dosjes së tenderit. Ky detyrim nuk zbatohet në rastin e kontratave sektoriale.”

Në zbatim të nenit të sipërpërmendur, Njësia e Prokurimit gjykon se kjo kontratë nuk mund të ndahet në lote për arsyet e mëposhtme:

Së pari- Autoriteti Kontraktor e ka të pamundur teknikisht ta ndajë këtë kontratë në lote të veçantë pasi objekti i prokurimit është vetëm një zë konkretisht Çadra Strehimi.

Së dyti-Autoriteti Kontraktor Përfituese, Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit ka në mision të saj ndërhyrjen në mënyrë operative për mbrojtjen e popullsisë, ekonomisë dhe mbrojtjes së vendit në situata të gjendjes së jashtëzakonshme, gjendjes së emergjencës civile, veprimeve terroriste ,ushtarake te cilat sjellin dëme të rënda për jetën, popullatën etj. Bazuar në misionin e saj, për menaxhimin e situatave emergjente, DPRMSH-ja duhet të jetë e plotësuar me kapacitete e saj operacionale per ti ardhur në ndihmë popullsisë në rast nevojë. Nisur nga rëndësia e furnizimit me mallin objekt prokurimi është parë e nevojshme që furnizimet të kryhen nga një operator ekonomik pasi furnizimi duhet të kryhet me përpikmëri brenda afatit të përcaktuar nga AK-ja përfitues. Ndryshimi i operatorëve ekonomikë që do të realizojnë objektin e kontratës gjatë zhvillimit të saj do të sillte problematika në funksionimin dhe linjën e furnizimit në kohë dhe sipas kushteve te percaktuara nga AK-të Përfituese.

Si përfundim, kontrata me një Operator Ekonomik në këtë procedurë do të garantonte sigurinë e furnizimeve sipas kushteve të përcaktuara dhe përmbushjen e saj me sukses sipas afateve të përcaktuara nga AK-të Përfituese.

Mos ndarja në lote e procedurës së prokurimit, nuk e kufizon tregun, pasi kriteret e hartuara ne DST janë gjithëpërfshirëse, kriteret kualifikuese janë hartuar në mënyrë të tillë që tu jepet hapësirë dhe mundësi të gjithë operatorëve ekonomikë të interesuar për tu bërë pjesë e procedurës të sipërcituar.

Për sa më lart Njësia e Prokurimit gjykon dhe argumenton se nuk ka vend për ndarjen në lotë të procedurës objekt prokurimi.

NJËSIA E PROKURIMIT